



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHËTËRËTOR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Komuna e Haraçinës

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor (630) për vitn 2021

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të liruara nga paraqitjet e gabuara materialisht, ndërsa aktivitetet dhe transaksionet që reflektohen janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- komuna nuk mbanë regjistër të pronës së patundshme, nuk lëshon vendime për borxhin për tatimin në pronë ndaj personave fizikë dhe juridikë, ndërsa tatimi i shitjes së patundshmërive dhe tatimi i trashëgimisë dhe dhuratës nuk përcaktohet në pajtim me Metodologjinë për përcaktimin e vlerës në treg;
- komuna nuk realizon të ardhura në bazë të: tatimit komunal të firmës, tatim komunal për shfrytëzimin e muzikës në lokalet publike, tatimit komunal për shfaqjen e reklamave, publikimit dhe shpalljeve në vende publike dhe të ardhura nga kompensimet për rregullimin e tokës ndërtimore;
- nuk është vendosur evidencë analitike të kërkesave për personat fizikë dhe juridikë.

Mendimi i dhënë *:

Shprehëm mendim të pavoritshëm për realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare, llogaria e buxhetit themelor (630) për vitin 2021 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Nuk ka pasqyr të plotë të arkëtimit dhe konfirmimit të të Ardhurave në bazë të tatimit komunal e cila paguhet gjatë regjistrimit të automjeteve dhe tatimit komunal për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik.

Rekomandimet kyçe:

- Kryetari i komunës të ndërmer masa dhe aktivitete për:
- vendosjen e regjistrit të pronës së patundshme dhe azhurnimin e tij dhe dhënien e vendimeve për tatimpaguesit për detyrimin e tyre dhe mbledhjen në kohë të kërkesave mbi këtë bazë;
 - përcaktimi dhe arkëtimi i tatimeve komunale dhe mbajtja e evidencës përkatëse në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore;
 - vendosjen e evidencës analitike të kërkesave për personat fizikë dhe juridikë.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje për Draft-Raportin nr. 133/1 nga 25.01.2023 të llogarisë së buxhetit themelor (630) për vitin 2021.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

/

* pozitive, me rezervë të pavoritshëm të përmbajtur